



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/33
Datë: 29.08.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, si dhe nenit 30 pika 3 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 gusht 2008, mori

V E N D I M

1. Nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendës drejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit.
2. Nga 1 shtatori 2008, përmes licencimit zëvendësohet sistemi linear i pagave përmes sistemit të dallimeve pozitive të pagave për të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendës drejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesionalë në nivelin fillor dhe atë të mesëm.
3. Ngritja e pagave për mësimdhënësit, drejtorët (zëvendës drejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesionalë në nivelin fillor dhe atë të mesëm bëhet në bazë të kriterëve të licencimit, si: përgatitja profesionale (kualifikimi) dhe përvoja e punës.
4. Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendës drejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesionalë, të pajisur:
 - 1) Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10 %
 - 2) Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19 %.
 - 3) Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%.
 - 4) Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %.
5. Personeli mësimdhënës, drejtorët (zëvendës drejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional përfitojnë ngritje prej 0.3 % të pagës bazë për një vit përvojë pune në shkollë, duke mos llogaritur tri vitet e para. Në bazë të përvojës së punës në shkollë, personeli mësimdhënës, drejtorët (zëvendës drejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesionalë përfitojnë ngritje prej 0 – 12 %.

6. Përqindja më e ulët dhe më e lartë e rritjes për secilën kategori dhe nivel të mësimdhënies (fillore dhe të mesme) sipas kualifikimit dhe përvojës është:
- 1) Me diplomë të Shkollës Normale përfiton ngritje të pagës bazë prej 10-22%.
 - 2) Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfiton ngritje të pagës bazë prej 19-31 %.
 - 3) Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfiton ngritje të pagës bazë prej 27 - 39 %.
 - 4) Me diplomë të ciklit të dytë dhe tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfiton ngritje të pagës bazë prej 35-47 %.
7. Nga një pjesë të projekteve kapitale të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, të parapara me planifikimet buxhetore për vitin 2008, merren 25 % e mjeteve të cilat do të destinohen për licencimin e mësimdhënësve.
8. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Shërbimeve Publike.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë